



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, kryegjykatës

Gjykatës Kristof Bart

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 shtator 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Konstatimin e Shkeljes së Detyrimit për Nxjerrjen e Materialeve lidhur me Dëshminë e W04714-ës

**Ushtruesit të Detyrës së
Zëvendësprokurorit të Specializuar**
Vard Ferdinandse

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 21(6) dhe 40 të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 102(3), 103, 110 dhe 116 Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 gusht 2023, Mbrojtja e Hashim Thaçit ("z. Thaçi"), Kadri Veselit ("z. Veseli"), Rexhep Selimit ("z. Selimi") dhe Jakup Krasniqit ("z. Krasniqi") (së bashku, "të akuzuarit" ose "Mbrojtja") paraqitën kërkesë të përbashkët para Trupit Gjykses duke kërkuar konstatimin e shkeljes së detyrimit për nxjerrjen e materialeve nga ana e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") ("Kërkesa").¹
2. Më 1 shtator 2023, ZPS-ja paraqiti përgjigjen ndaj Kërkesës ("Përgjigja").²
3. Më 11 shtator 2023, Mbrojtja paraqiti kundërpërgjigjen e përbashkët ("Kundërpërgjigja").³

II. PARASHTRIMET

4. Mbrojtja parashtron se W04714 i dha ZPS-së informacion shfajësues gjatë intervistës së 28 gushtit 2020, që duhet të nxirrej menjëherë për të akuzuarit në përputhje me rregullën 103.⁴ ZPS-ja nuk e nxori informacionin edhe pse e kishte në posedim për disa vite.⁵ Ndërsa versioni në anglishte i transkriptit të intervistës

¹ F01729, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Konstatim të Shkeljes së Detyrimit për Nxjerrjen e Materialit në lidhje me Dëshminë e W04714-ës*, 22 gusht 2023, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale.

² F01758, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes F01729*, 1 shtator 2023, konfidenciale.

³ F01781, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes F01729*, 11 shtator 2023, konfidenciale.

⁴ Kërkesa, para. 1-2.

⁵ Kërkesa, para. 29.

iu dha Mbrojtjes më 7 gusht 2023 dhe versioni në shqipe iu dha më 28 gusht 2023 në përputhje me detyrimet e ZPS-së për nxjerrje materiali sipas rregullës 102(3),⁶ Mbrojtja pretendon se nevojitet ndërhyrja e Trupit Gjykses.⁷

5. Mbrojtja kërkon nga Trupi Gjykses që: (i) të konstatojë se dëshmia e W04714-ës është shfajësuese; (ii) të konstatojë se ZPS-ja nuk i ka përmbushur plotësisht detyrimet për nxjerrje materiali sipas rregullës 103 në lidhje me dëshminë e W04714-ës; (iii) të urdhërojë ZPS-në që të rishikojë materialet në posedim, përfshirë intervistat me dëshmitarë, dhe të konfirmojë se nuk ka materiale të tjera që duhej të nxirreshin sipas rregullës 103 ose rregullës 102(3) të cilat ende nuk janë nxjerrë; (iv) të ritheksojë se ZPS-ja udhëzohet të përmbushë detyrimet për nxjerrje materiali me përparësi, që kërkon kohë dhe mjete në pajtim me rëndësinë e tyre, dhe të adoptojë konceptim të gjerë të detyrimeve të veta për nxjerrje materiali sipas rregullës 103; dhe (v) të shqyrtojë në mënyrë të duhur çdo kërkesë të Mbrojtjes për shtyrjen e dëshmive të dëshmitarëve të ZPS-së materiali provues i të cilëve është nxjerrë ose do të nxirret me vonesë, ku vonesa e nxjerrjes së materialit përkatës pati pasoja të qarta për aftësinë e Mbrojtjes që të përgatitet në mënyrë efektive.⁸

6. Në përgjigjen e vet, ZPS-ja pranon se e kishte nxjerrë intervistën e W04714-ës me vonesë.⁹ ZPS-ja fajëson për këtë një gabim administrativ lidhur me punësimin e W04714-ës në një shtet të tretë.¹⁰ ZPS-ja argumenton se Mbrojtja nuk ka pësuar dëm sepse transkripti është një dokument me 37 faqe që u nxor tri javë para dhënies së dëshmisë me gojë prej W03832-shit, duke i dhënë Mbrojtjes kohë të mjaftueshme për të përfshirë informacionin e ri në përgatitjen për marrjen në

⁶ Kërkesa, para. 1. *Shih* Paketën nr. 882 të Materialit të Nxjerrë: 077611-TR-ET pjesa 1 RED, 077611-TR-ET pjesa 2; Paketa nr. 904 e Materialit të Nxjerrë : 077611-TR-AT pjesa 1 RED, 077611-TR-AT pjesa 2.

⁷ Kërkesa, para. 4.

⁸ Kërkesa, para. 5.

⁹ Përgjigjja, para. 2, 11.

¹⁰ Përgjigjja, para. 2, 7.

pyetje të W03832-shit.¹¹ ZPS-ja pretendon më tej se Mbrojtja gabimisht e cilëson transkriptin e intervistës së W04714-ës si material të rregullës 103.¹² ZPS-ja pretendon se intervista e W04714-ës është shumë e ngjashme me dëshminë e dhënë nga W03832 në intervistën e tij, dhe, rrjedhimisht, transkripti i intervistës së W04714-ës duhet të konsiderohet material i rregullës 102(3).¹³ ZPS-ja thotë se ka verifikuar se janë nxjerrë transkriptet e intervistave të dëshmitarëve në pozitë të ngjashme.¹⁴ ZPS-ja gjithashtu pretendon se i koncepton në mënyrë të gjerë dhe me ndershmëri detyrimet e veta për nxjerrjen e materialit sipas rregullës 103.¹⁵ Duke u bazuar në këto rrethana, ZPS-ja pretendon se mjeti juridik i kërkuar nga Mbrojtja është i panevojshëm dhe i tepruar.¹⁶

7. Mbrojtja kundërpërgjigjet se, nëse ZPS-ja besonte se deklarata e W04714-ës konfirmonte dëshminë e W03832-shit, do ta kishte thirrur W04714-ën si dëshmitar.¹⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Sipas nenit 21(6) të Ligjit, të gjitha provat ose faktet materiale dhe relevante që i posedon Zyra e Prokurorit të Specializuar të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit vihen në dispozicion të të akuzuarit para fillimit të procedurës dhe gjatë saj, dhe i nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve që janë rreptësisht të nevojshme dhe atëherë kur zbatohen mbrojtjet e nevojshme kundër-balancuese.

9. Sipas rregullës 103 të Rregullores, në varësi të rregullave 107 dhe 108 të Rregullores, Prokurori i Specializuar i vë menjëherë në dispozicion Mbrojtjes çdo

¹¹ Përgjigjja, para. 2, 14-15.

¹² Përgjigjja, para. 3, 16-21.

¹³ Përgjigjja, para. 3.

¹⁴ Përgjigjja, para. 4.

¹⁵ Përgjigjja, para. 5.

¹⁶ Përgjigjja, para. 5, 23.

¹⁷ Kundërpërgjigjja, para. 7.

informacion për të cilin ka arsye të besohet se sugjeron pafajësinë, apo lehtëson fajësinë e të akuzuarit, apo ndikon në besueshmërinë ose mbështetshmërinë e provave të Prokurorit të Specializuar.

10. Sipas rregullës 110, me kërkesën e njëjës prej palëve ose *proprio motu*, trupi gjykues mund të vendosë për masat që do të merren si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve të nxjerrjes së materialit në bazë të Rregullores, ndër të cilat edhe pezullimi i procesit dhe përjashtimi i provave, përveç provave shfajësuese.

IV. DISKUTIM

A. A I KA SHKELUR ZPS-JA DETYRIMET PËR NXJERRJEN E MATERIALIT

11. Vlerësimi se cili material duhet të nxirret sipas rregullës 103 është i bazuar në fakte dhe kryesisht, është kompetencë diskrecionale dhe përgjegjësi e ZPS-së.¹⁸ Në përgjithësi, Trupi Gjykues “respekton funksionin e Prokurorisë në administrimin e drejtësisë, dhe kryerjen e këtij funksioni nga Prokuroria me ndershmëri.”¹⁹ Megjithatë, në pajtim me rregullën 110, Trupi Gjykues mund të vendosë të marra masa si rezultat i çfarëdo konstatimi të mospërmbushjes së detyrimeve nga ZPS-ja për nxjerrjen e materialit. Përmbushja e këtyre detyrimeve është element i rëndësishëm i gjykimit të drejtë në një sistem normativ siç është ai që zbatohet para kësaj gjykate dhe është thënë se është po aq i rëndësishëm sa detyrimi për të ndjekur penalisht.²⁰

¹⁸ *Shih p.sh. Kordić and Čerkez Appeal Judgment*, para. 183; *Blaškić Appeal Judgment*, para. 264; *Karadžić Decision*, para. 15.

¹⁹ *Shih p.sh. Kordić and Čerkez Appeal Judgment*, para. 183; *Karadžić Decision*, para. 15.

²⁰ *Shih p.sh. ICTY, Prosecutor v. Kordić and Čerkez*, IT-95-14/2-A, Judgement (“*Kordić and Čerkez Appeal Judgment*”), 17 December 2004, paras 183, 242; *Prosecutor v. Krstić*, IT-98-33-A, Judgement (“*Krstić Appeal Judgment*”), 19 April 2004, para. 180; *Prosecutor v. Blaškić*, IT-95-14-A, Judgement (“*Blaškić Appeal Judgment*”), 29 July 2004, para. 264; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Decision on Accused’s Seventeenth Motion for Finding of Disclosure Violation and for Remedial Measures (“*Karadžić Decision*”), 29 September 2010, para. 15.

12. Trupi Gjykues vë në dukje se, sipas rregullës 103, kërkohet nxjerrja e materialit “për të cilin ka arsye të besohet se sugjeron pafajësinë, apo lehtëson fajësinë e të akuzuarit, apo ndikon në besueshmërinë ose mbështetshmërinë e provave të Prokurorit të Specializuar.” Gjykohet se materiali ndikon në besueshmërinë e provave të prokurorisë nëse cenon provat e paraqitura nga prokuroria në gjykim.²¹ Është e qartë nga formulimi diskrecional në rregullën 103 se nga ZPS-ja nuk pritët që të përcaktojë në mënyrë përfundimtare nëse materiali në fjalë ndikon apo jo në besueshmërinë dhe mbështetshmërinë në provat e ZPS-së para se ta nxjerrë sipas kësaj rregulle. Detyra e ZPS-së është që të dorëzojë materialin që “ka arsye të besohet” se mund të ndikojë në besueshmërinë ose mbështetshmërinë në provat e ZPS-së. Provat që do të kundërshtonin dëshminë e një dëshmitari të ZPS-së për një pikë të rëndësishme materiale, përgjithësisht do të hynin në kategorinë e informacionit për t’u nxjerrë sipas rregullës 103.²²

13. Për vërtetimin e shkeljes së detyrimit të Prokurorisë sipas rregullës 103, Mbrojtja duhet të “argumentojë *prima facie* natyrën me gjasë shfajësuese ose lehtësuese” të materialeve në fjalë dhe mosnxjerrjen e tyre “menjëherë” nga ZPS-ja, d.m.th., shpejt dhe pa vonesa të papërligjura.²³ Në qoftë se vërtetohet kjo, Trupi Gjykues vendos se çfarë masash janë të përshtatshme për ta trajtuar shkeljen.²⁴ Ekzistenca e dëmit të vërtetueshëm për të akuzuarit është faktori parësor për të vendosur se çfarë reagimi apo mase është e përshtatshme në rastin e caktuar.²⁵

²¹ *Shih p.sh. Karadžić Decision*, para. 14; *Krstić Appeal Judgment*, para. 178.

²² *Shih p.sh. ICTY: Prosecutor v. Gotovina, IT-06-90-T, Decision on Ivan Cermak’s Motion Requesting the Trial Chamber to Order the Prosecution to Disclose Rule 68 Material to the Defence*, 7 August 2009, para. 11; *Prosecutor v. Naser Orić, IT-03-68-T, Decision on Urgent Defence Motion Regarding Prosecutorial Non-Compliance with Rule 68*, 27 October 2005, f. 2, 4.

²³ *Shih p.sh. Kordić and Čerkez Appeal Judgment*, para. 179; *Karadžić Decision*, para. 14.

²⁴ F00936, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet e Mbrojtjes së Thaçit dhe Krasniqit që Kërkojnë Mjet Juridik për Mospërbushje të Detyrimeve të Nxjerrjes së Materialit*, 26 gusht 2022, konfidencial, para. 15; F01245, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Thaçit për Konstatimin e Mosnxjerrjes së Materialeve*, (“Vendimi i Trupit Gjykues mbi Mosnxjerrjen e Materialeve nga ZPS-ja”) 1 shkurt 2023, para. 27-29.

²⁵ *Shih p.sh. Karadžić Decision*, para. 17; *Kordić and Čerkez Appeal Judgment*, para. 179; *Blaškić Appeal Judgment*, para. 268.

14. Në rastin konkret, Trupi Gjykses nuk ka nevojë të përcaktojë nëse deklarata e W04714-ës me të vërtetë kundërshtonte dëshminë e W03832-shit për një pikë me rëndësi materiale dhe nëse si rrjedhojë duhej të nxirrej sipas rregullës 103. Ky informacion u nxor në pajtim me rregullën 102(3)²⁶ dhe, si rezultat, mund të përdorej dhe u përdor nga Mbrojtja për përgatitjen e marrjes në pyetje të W03832-shit.²⁷

15. Sa i përket kohës së nxjerrjes së materialit, ZPS-ja pranon se nuk i ka përmbushur detyrimet për nxjerrje materiali duke mos nxjerrë intervistën e W04714-ës më herët.²⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe ky Trup Gjykses kishin përcaktuar afate konkrete për përmbylljen e detyrimeve të ZPS-së për nxjerrje materiali sipas rregullës 102(3)²⁹ dhe rregullës 103,³⁰ të cilat ZPS-ja nuk i përmbushi në këtë rast. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se, pavarësisht nëse zbatohet kriteri për nxjerrje të menjëhershme i rregullës 103, ose i rregullës 102(3), ZPS-ja nuk e nxori materialin në kohën e duhur.

²⁶ *Shih* Paketën nr. 882 të Materialit të Nxjerrë: 077611-TR-ET pjesa 1 RED, 077611-TR-ET pjesa 2.

²⁷ *Shih p.sh.* Transkriptin, 28 gusht 2023, f. 6859; Transkripti, 29 gusht 2023, f. 6888-6892 (ku Mbrojtja i referohet transkriptit të intervistës).

²⁸ Përgjigja, para. 11, 14.

²⁹ *Shih p.sh.* F00370, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit për Zgjatjen e Afatit për Dhënien e Njoftimit sipas Rregullës 102(3)*, 24 qershor 2021, para. 16 (ku zgjatet afati për ZPS-në të dorëzojë njoftimin sipas rregullës 102(3) për materialet në posedim deri më 20 korrik 2021); Transkripti, 13 korrik 2022, f. 1475-1475 (ku Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton ZPS-në për urdhrin e tij të 20 majit 2022 për nxjerrjen e të gjithë materialit sipas rregullës 102(3) dhe që nuk janë objekt i kërkesave për masa mbrojtëse ose i kundërshtimeve në lidhje me rëndësinë materiale deri më 30 shtator 2022); F01226/A01, Trupi Gjykses, *Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 25 janar 2023, para. 22, 24 (ku kujtohet ZPS-ja se ka detyrim të vazhdueshëm të nxjerrë materialin e rregullës 102(3) pa vonesë, dhe urdhërohet që kur të fillojë gjykimi, ZPS-ja duhet të nxjerrë menjëherë materialin e ri të rregullës 102(3) që ka në posedim); Transkripti, 15 shkurt 2023, f. 1948-1949 (ku Trupi Gjykses vë në dukje se dëshiron që ZPS-ja të përmbyllë nxjerrjen e materialeve në posedim, gjë me të cilën ZPS-ja pajtohet me përjashtim të materialeve të rregullës 102(3) të marra para pak kohe, që shtyu Trupin Gjykses të urdhërojë ZPS-në që të lëshojë njoftimin plotësues sipas rregullës 102(3) për këto materiale deri më 17 shkurt 2023).

³⁰ *Shih p.sh.* Transkriptin e seancës, 24 mars 2022, f. 1161, rreshti 24 deri f. 1162, rreshti 2 (Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi ZPS-në të përmbyllte shqyrtimin dhe nxjerrjen e materialit të marrë të rregullës 103 deri më 31 janar 2022); Vendimi i Trupit Gjykses mbi Mosnxjerrjen e Materialeve nga ZPS-ja, para. 33(b) (pas konstatimit të shkeljes së rregullës 103, ku urdhëron ZPS-në të trajtojë me përparësi detyrimet për nxjerrje materiali dhe të konceptojë në mënyrë të gjerë detyrimet e veta për nxjerrje materiali sipas rregullës 103103).

B. DËMI

16. Nxjerrja e deklaratave të W04714-ës u bë më 7 gusht 2023.³¹ Dëshmia e W03832-shit filloi në mëngjesin e 28 gushtit 2023,³² duke u dhënë të akuzuarve tri javë që të përfshinin informacionin e deklaratave të W04714-ës në përgatitjet e tyre për marrje në pyetje të W03832-shit. Veçanërisht, deklarata e W04714-ës është afërsisht 37 faqe,³³ dhe komentet në fjalë janë përfshirë brenda disa rreshtave.³⁴

17. Duke u bazuar në këtë periudhë kohore dhe rrethanat e tjera relevante të përshkruara më lart, Trupi Gjykes nuk bindet se nxjerrja e materialeve është bërë aq vonë sa të pengonte përgatitjen efektive nga të akuzuarit të dëshmisë së W03832-shit në shkallë të konsiderueshme. Mbrojtja kishte kohë të mjaftueshme të shqyrtonte materialin dhe ta përdorte për marrjen në pyetje të W03832-shit.³⁵ Veçanërisht, të akuzuarit nuk i kërkuan Trupit Gjykes të shtynte dëshminë e W03832-shit.³⁶ Rrjedhimisht, Trupi Gjykes konstaton se të akuzuarit nuk janë dëmtuar nga nxjerrja e vonshme e deklaratave të W04714-ës.

C. MASAT E PËRSHTATSHME

18. Veprimet e ZPS-së përmbushin kriterin e mosrespektimit brenda kuptimit të rregullës 110 të Rregullores, dhe, rrjedhimisht përlligjin miratimin e “masave të përshtatshme”.³⁷ Rrjedhimisht, Trupi gjykes do t’i vlerësojë masat e përshtatshme për t’u zbatuar në rrethanat konkrete të çështjes.

³¹ *Shih* Paketën 882 të Materialit të Nxjerrë 882: 077611-TR-ET pjesa 1 RED, 077611-TR-ET pjesa 2.

³² Transkripti, 28 gusht 2023, f. 19.

³³ *Shih* 077611-TR-ET pjesa 1 RED, 077611-TR-ET pjesa 2.

³⁴ *Shih* 077611-TR-ET pjesa 1 RED, f. 23.

³⁵ *Shih p.sh.* Transkriptin, 28 gusht 2023, f. 6859; Transkripti, 29 gusht 2023, f. 6888-6892 (Mbrojtja i referohet transkriptit të intervistës); *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen, para. 5.

³⁶ Vendimi i Trupit Gjykes mbi Mosnxjerrjen e Materialeve nga ZPS-ja, para. 29 (ku pasqyrohet zotimi i këtij Trupi Gjykes për ta bërë këtë).

³⁷ Vendimi i Trupit Gjykes mbi Mosnxjerrjen e Materialeve nga ZPS-ja, para. 11.

19. Ekzistenca e dëmit të vërtetueshëm për të akuzuarit është faktori parësor për marrjen e vendimit se çfarë përgjigje ose mase është e përshtatshme në një çështje të caktuar.³⁸ Masa e përshtatshme duhet të merret duke pasur parasysh faktin që të akuzuarit nuk pësuajnë dëm të vërtetueshëm si rezultat i nxjerrjes së materialit pas afatit nga ZPS-ja. Trupi Gjyqësor pranon, megjithatë, se nxjerrja e informacionit përkatës në momentin e fundit për Mbrojtjen do të shtonte presionin ndaj Mbrojtjes kur përgatitjet për marrje në pyetje janë në fazën e fundit.

20. Rrjedhimisht, Trupi Gjyqësor përsërit rëndësinë e përbushjes në kohë dhe të zellshme nga ana e ZPS-së të detyrimeve për nxjerrjen e materialit. Në lidhje me këtë, Trupi Gjyqësor vë në dukje me kënaqësi se ZPS-ja ndërmori disa veprime për të siguruar që kjo nuk do të përsëritet, përfshirë: (i) verifikimin e nxjerrjes së deklaratave të individëve që konsideroheshin dëshmitarë, por që në fund nuk u zgjodhën; (ii) verifikimin e nxjerrjes së të gjitha transkripteve të intervistave të ZPS-së/Task Forcës Hetimore Speciale; dhe (iii) angazhimin për rishikimin e mëtejshëm të materialeve, përfshirë ato që mund të jenë nxjerrë në të kaluarën vetëm pjesërisht, ose që janë nxjerrë vetëm si version tjetër i të njëjtit material.³⁹ Rrjedhimisht, Trupi Gjyqësor nuk gjykon se ka nevojë të urdhërohen masa shtesë në këtë fazë. ZPS-ja ka për detyrë të përbushë detyrimet për nxjerrje të materialit sipas Rregullores dhe pritet që ta bëjë këtë në kohë dhe në mënyrë të zellshme.

V. VENDIM

21. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjyqësor:

- a) **KONSTATON** se nxjerrja e deklaratës së W04714-ës nuk u bë brenda afatit;

³⁸ Vendimi i Trupit Gjyqësor mbi Mosnxjerrjen e Materialeve nga ZPS-ja, para. 11 (citohet [Karadžić Decision](#), para. 17; [Kordić and Čerkez Appeal Judgment](#), para. 179; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 268).

³⁹ Përgjigja, para. 11.

- b) **KONSTATON** se të akuzuarit nuk u dëmtuan nga nxjerrja e vonuar e deklaratës së W04714-ës;
- c) **RITHEKSON** rëndësinë e përmbushjes në kohë dhe të zellshme nga ana e ZPS-së të detyrimeve për nxjerrje të materialit; dhe
- d) **HEDH POSHTË** pjesën e mbetur të masave ndreqëse të propozuara prej Mbrojtjes.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 15 shtator 2023

Në Hagë, Holandë.